



Pranimi / Doneshit / Prilazja / Prilazja / Prilazja / Prilazja	26.04.2021	1	viti / god / Year
Organizata / Organizata / Organizata	2003/2021	Shtesa / Prilazja / Prilazja	Sasia / Kuhuma / Quantity
SKIMSHEK	2003/2021		116



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.196/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Eshref Shabani-anëtarë,si dhe Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Tartë për Bashkëpunim Profesional, sipas Aktgjykimin A.nr.2725/19 A.nr.2725/19,datë 26/03/2021,të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.548/2019 të datës 17.09.2019 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi rruga "Dedë Xheluli", Nr. 143 në Prishtinë, kundër Vendimit me Nr.14-070/01-0196434/19 të datës 10.09.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Prishtinës në çështjen juridike "ndërprerje e marrëdhënies së punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 26.04.2021, mori këtë:

V E N D I M

I.APROVOHET si e bazuar, ankesa me numër A.nr.548/2019 e datës 17.09.2019 parashtruar nga ankuesi

II.ANULOHEN Vendimi i datës 26.07.2019 i protokoluar më datë 29/07/2019 me numër 14-116/01-184530/19 i Komisionit Disiplinor, dhe vendimi i datës 10.09.2019, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave,me numër 14-070/01-0196434/19.

III. OBLIGOHET Kryetari i Komunës së Prishtinës, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij, duke e kthyer ankuesin, në pozitën "Zyrtar për Ndërtim", sipas akt emërimit 01.NR.112-859 të datës 01/08/2016, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga

marrëdhënia e punës dhe duke bërë kompensimin e pagës nga dita e ndërprerjes së marrëdhënies së punës deri në zbatimin e këtij vendimi.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ndaj ankuesit [] i punësuar në Komunën e Prishtinës, më datë 05.06.2019 Kryetari i Komunës, së Prishtinës, ka bërë kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore në Komisionin Disiplinor.

Komisioni Disiplinor i Komunës së Prishtinës, me datën 20.06.2019, ka nxjerr Vendim me numër 2467, me të cilin ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore "Ndërprerje e marrëdhënies së punës".

Ankuesi [] i pakënaqur me vendimin e datës 20.06.2019, të Komisionit Disiplinor, më datë 09.07.2019, me numër protokoli 14-117/01-0161302/19, ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Prishtinës.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Prishtinës, ka nxjerr vendim me numër 14-117/0161302/19, me date 17.07.2019, me të cilin e kthen në rishqyrtim tek Komisioni Disiplinor, ankesën e ankuesit []

Komisioni Disiplinor i Komunës së Prishtinës, me datën 29.07.2019, ka nxjerr vendimin me Nr. 14-116/01-184530119, me të cilin e aprovon vendimin e datës 17.07.2019, të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Prishtinës për të rishqyrtuar vendimin e datës 20.06.2019, dhe ka lenë në fuqi masën e rëndë disiplinore " Ndërprerje nga Marrëdhënia e Punës " për ankuesin []

Ankuesi [] i pakënaqur me vendimin e datës 29.07.2019, të Komisioni Disiplinor, me datën 13.08.2019, ka parashtruar ankesën me numër 14-070/01-0196434/19, tek Komisionin për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Prishtinës.

Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Prishtinës, me datën 10.09.2019, ka nxjerr vendim me të cilin e refuzon ankesën e ankuesit, duke e lenë në fuqi vendimin e Komisionit Disiplinor ne çështjen juridike" Ndërprerje nga marrëdhënia e punës" .

Ankuesi [] i pa kënaqur me vendimin e datës 10.09.2019 me nr.14-070/01-0196434/19 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Prishtinës, më datë 17.09.2019, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 24.09.2019, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Komuna e Prishtinës. Komuna e Prishtinës, më datë 16.10.2019, ka përcjell në Këshilli përgjigjen në ankesë së bashku me dokumentacionin e kërkuar 1/41,faqe.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri në tetor 2020,ku më datë 08.10.2020 janë zgjedhë 5 anëtar të këshillit ndërsa më datë 14/10/2021 janë themeluar edhe kolegjet profesionale, ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa më datë 05.11.2019, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi i pakënaqur me njoftimin e datës 05.11.2019 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, ka hapur konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore Departamenti për Çështje Administrative,me aktgjykimin me numër A.nr.2725/19 të datës 25.03.2021, ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar njoftimin e datës 05.11.2019, dhe duke detyruar KPMSHCK-në që në afat prej 30 ditësh ta shqyrtoj ankesën Nr.548/2019 të datës 17.09.2019 të ankuesit

Kolegji bazuar në aktgjykimin e lartpërmendur për shqyrtimin e ankesës për marrjen e vendimit meritor ka administruar këto prova: Ankesën me numër te protokollit 4358/2019 të datës 17.09.2019 te parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës;Vendimin e të datës 10.09.2019 te Komisionit për zgjedhjen e Kontesteve dhe ankesave të Komunës së Prishtinës; Vendimin me numër 2467 të datës 20.06.2019; Vendimin e datës 17.07.2019 te Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Prishtinës; Vendimin me numër 14-116/01-184530/19 te datës 29.07.2019 te Komisionit disiplinore të Komunës se Prishtinës;Raporti javor(27.05.2019-31.05.2019) i ankuesit në adresë të u.d.shefit të sektorit i datës 10.06.2019,2 faqe 17 dhe 18, Raporti javor(20.05.2019-24/05/2019) i ankuesit në adresë të u.d.shefit të sektorit i datës 31.05.2019,2 faqe 19 dhe 20; Raporti javor(28.01.2019-01/02/2019) i ankuesit në adresë të u.d.shefit të sektorit i datës 05.02.2019,2 faqe 21 dhe 22 ;Raporti javor(21.01.2019-25/01/2019) i ankuesit në adresë të u.d.shefit të sektorit i datës 05.02.2019,2 faqe 22 dhe 23; Raporti javor(12.11.2018-16/11/2018) i ankuesit në adresë të u.d.shefit të sektorit i datës 21.11.2018,2 faqe 24 dhe 25; Raporti javor(25.06.2018-29/06/2018) i ankuesit në adresë të u.d.shefit të sektorit i datës 03.07.2018,2 faqe 26 dhe 27;Raporti javor(07.05.2018-11/05/2018) i ankuesit në adresë të u.d.shefit të sektorit i datës 11.05.2018,2 faqe 28 dhe 29; Raporti javor(16.04.2018-20/04/2018) i ankuesit në adresë të u.d.shefit të sektorit i datës 23.04.2018,2 faqe 30 dhe 31; Shkresë e datës 18.04.2018,lënda me nr.09-354/02-



0092621/18,faqe 32;Raporti në adresë të u.d.shefit të sektorit(foto dhe përshkrim të objekteve në ndërtim e sipër) deri më 27.02.2019,faqe 36 deri faqe 66;shkresa e datës 18/04/2018 ku konfirmohet një rrënim i datës 26/06/2018 në lidhje me objektin kontestues,faqe 67; ;Procesverbali me numër 000814/18 i datës 31.05.2019 me disa foto nga faqja 69 deri në faqen 72 për kontrollin inspektues; Aktvendimi për rrënim me numër 354/02-0092621/18 i datës 27.05.2019,faqe 73 ; Procesverbali për kontrollin inspektues me numër 000811/18 i datës 24.05.2018 dhe dy foto datë 24/05/2019,faqe 74 dhe 75; Flet dorëzimi nr.014303 i datës 27.05.2019,faqe 76;dy foto të datës 25/01/2019,faqe 77 dhe 78;Procesverbali me numër 001105/2018 i datës 25.01.2019,faqe 79; Fletedorzimi me Nr. 354-014210 i datës 28.01.2019 dhe Thirrja për palën (Ftesë) me Nr. 354-014216 e datës 25.01.2019,faqe 80; Foto dëshmi për ndërtimin në lagjen Mati 1; Aktvendimi për ndërprerje të punimeve me numër 354/02-002621/18 i datës 13.11.2018,faqe 83; Flete dorëzimi me numër 354-001596 i datës 12.11.2018; Foto dëshmi për ndërtimin e objektit ne lagjen Mati 1 të datës,11/11/2018 dhe 12/11/2018,faqe 85 deri 88; Procesverbali me numër 001317/2018 i datës 13.11.2018,faqe 89;disa foto të objektit të rrënuar, faqe 90 deri 96; Procesverbali me numër 003177/2018 i datës 26.06.2018 mbi ekzekutimin e vendimit të rrënitit të datës 08/05/2018,faqe 97;Aktvendimi mbi urdhëresën e palës për rrënim të objektit, me numër 354/02-0092621/18 i datës 08.05.2018,faqe 98; Flete dorëzimi me numër 354 i datës 07.05.2018, katër foto,faqe 100/101; Procesverbali/urdhëresa për ndërprerje të punimeve me numër 356 i datës 07.05.2018,faqe 102; Procesverbali/urdhëresa për ndërprerje të punimeve me numër 356 i datës 23 dhe 24.04.2018,faqe 103; Foto dëshmi e datës 23.04.2018 dhe 24/04/2018,faqe 104/106; Flet dorëzimi numër 354-004440 i datës 23.04.2018,faqe 107; Aktvendimi për ndërprerje të punimeve me numër 354 i datës 17.04.2018,faqe 108; Kopja e planit e nxjerr nga agjencia katastrale e Kosovës për parcelën me sipërfaqe 364,0,datë 21/03/2018,faqe 109; Certifikata pronës e datës 21.03.2018,faqe 109/110; Foto dëshmi e datës 16.04.2018,faqe 112/115;Dokumenti i identifikimit i z, Agim Mani,faqe 116; Autorizimi i datës 22.03.2018,faqe 117; Procesverbali/urdhëresa për ndërprerje të punimeve Procesverbali me numër 356-2536 i datës 17.04.2018,faqe 118; Thirrja për palën me numër 354-004426 e datës 16.04.2018,faqe 119; Flet dorëzimi me numër 354-004426 i datës 16.04.2018,faqe119; kërkesa për legalizim e datës 02.11.2010,faqe 120.

Provat e mësipërme janë të dorëzuara nga ankuesi dhe janë të evidentuara në këtë vendim sipas renditjes me numra.

Kërkesa për përgjigje ne ankese e datës 24.09.2019,dërguar organit të punësimit nga KPMSHICK-ja.

Ndërsa më poshtë janë provat që janë objekt të administrimit dorëzuar nga organi i punësimit; Përgjigja në kërkesë e datës 16.10.2019 me numër te protokollit 4866/2019,faqe 1; Akt Emërimi i datës 01 nr.112-859 01.08.2016 në emër të ankuesit, faqe 2 dhe 3;Përshkrimi i detyrave të punës për ankuesin, faqe 4 dhe 5 ;Raporti i një shkelje disiplinore te supozuar me numër 14-116/01-128769/19 i datës 03.06.2019,faqe 6 dhe 7; Fletëthirrja për ankuesin për seancë nga Komisioni Disiplinorë i Komunës se Prishtinës dhe Flet dorëzimi, faqe 8; Procesverbali i datës 19.06.2019,faqe 9 deri 14; Ankesa me numër 14-070/101-196434/19 e datës 13.08.2019,faqe 15 deri 18; Emali i datës 15.10.2019 dhe 19.06.2019,faqe 41;shkresë

informuese nga drejtori i inspektionit të komunës së Prishtinës, faqe 39 dhe 40; Njoftimi i datës 05.11.2019 me numër të protokollit 5164/2019;Përgjigje në kërkesë e datës 21/04/2021 dhe vendimi për formimin e komisionit disiplinor i datës 16/05/2018 me nr.14-020/02-114750/18.

Ndërsa po ashtu nga organi i punësimit janë dorëzuar edhe vendimet e datës 29/07/2019,10/09/2019 dhe datës 20/06/2019 si dhe përshkrimi i detyrave të punës sipas konkursit të shpallur, por të cilat janë sjellë edhe nga ankuesi andaj edhe nuk u specifikuan më tepër, nga se janë të administruara më lartë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në lidhje me vendosjen meritore për këtë çështje,pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankuesit është e bazuar, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka konstatuar se Komisioni Disiplinor i Komunës së Prishtinës, sipas vendimit të datës 26.07.2019 i protokolluar më datë 29/07/2019,me numër protokollit 14-116/01-184530/19 i ka shqiptuar masën Disiplinorë, 'Ndërprerje e marrëdhënies së punës' 'në Shërbimin Civil.

Lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit se me rastin e shqiptimit të masës disiplinore''Ndërprerje e marrëdhënies së punës''është vepruar në kundërshtim me ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës si dhe rregulloren 04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil ,mbi këtë bazë Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, neni 87 paragrafi 1 i cili përcakton se: *"Nëpunësi civil shkarkohet nga shërbimi civil për shkak të performancës dhe rezultateve të dobëta, shkeljes së kodit të mirësjelljes dhe shkeljes së ligjit, i cili ka rezultuar me veprë penale, siç është përcaktuar me këtë ligj."* si dhe neni 66 paragrafi 1 dhe 2, i të njëjtit ligj cilët përcaktojnë se: *"1.Masat disiplinore zbatohen në mënyrë graduale dhe në proporcion me pasojat dhe dëmet e shkaktuar nga sjellja e nëpunësit civil. Rastet e shkeljeve jashtëzakonisht të rënda përcaktohen me akt nënligjor"* si dhe *"2. Shkeljet e detyrave të punës ndahen në: shkelje të lehta dhe shkelje të rënda - serioze të cilat do të rregullohen me akt nënligjor "* si dhe dispozitat e Rregullores nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, neni 6 paragrafi 1 nënparagrafi 1.12 i cili përcaktojnë se: *"dështimi i deklaramit ose dhënia e deklaratës të rrejshme në lidhje me konfliktin e interesit"*, si dhe neni 8 paragrafi 1, nënparagrafët 1.4 i të njëjtës rregulloreje të cilët përcaktojnë se: *1.4 ndërprerja e marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil nga komisioni disiplinor, pa dëmtuar apo reduktuar të drejtën në pension"*, andaj mbi këtë bazë Kolegji vlerëson se masa disiplinore "ndërprerje e marrëdhënies së punës" është masa më e rëndë që shqiptohet në Shërbimin Civil dhe se nga provat që janë shqyrtuar dhe analizuar me kujdesë nga kolegji me rastin e administrimit të tyre nuk është vërtetuar se ka pasur bazë të mjaftueshme ligjore konformë Ligjit Nr. 03/L-149 Për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës për shqiptimin e masës disiplinore të atakuar nga ankuesi sipas kësaj ankese.

Po ashtu Kolegji për Shqyrtimin dhe vendosjen e Ankesave ka konstatuar se Komisioni Disiplinor i Komunës së Prishtinës, me rastin e shqiptimit të masës disiplinore "Ndërprerje e marrëdhënies së punës" sipas vendimit të datës 29.07.2019, me numër protokollit 14-116/01-184530/19, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 71, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1,1.2 dhe 1.3, të Ligjit Nr. 03/L-149 Për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku thuhet se: „1. Komisioni disiplinor ka këto kompetenca: 1.1. të dëgjojë provat lidhur me shkeljen e supozuar; 1.2. të vendosë, në bazë të provave, nëse është kryer shkelja;dhe 1.3. përcakton dënimin që duhet shqiptuar”,si dhe në kundërshtim me nenin 8 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Rregullores Nr. 04/2011, për Procedura Disiplinor në Shërbimin Civil, ku thuhet se: 1.për shkeljet e rënda - serioze të përcaktuar me nenin 6 të kësaj Rregullore, nëpunësit civil , mund t'i shqiptohen këto masa disiplinore: 1.4.Ndërprerje e marrëdhënies së punës në Shërbimin civil nga Komisioni Disiplinor pa dëmtuar apo rekrutuar të drejtën në pension. Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se Komisioni Disiplinor në rastin e shqiptimit të masës disiplinore "Ndërprerje e marrëdhënies së punës në shërbimin civil", ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi të shërbimit civil sepse nëpunësi civil mbi bazën e shqyrtimit dhe analizimit të provave që janë bërë nga kolegji është konstatuar se nga autoriteti punëdhënës në këtë rastë komuna e Prishtinës përmes kërkesës për inicim të procedurës disiplinore, komisioni disiplinor dhe ai i ankesave nuk kanë arritë të argumentojnë përmes provave konkrete se ankuesi ka bërë shkelje të rëndë të detyrave të punës,për të i shqiptuar masën më të rëndë të ndërprerjes së mardhënies së Punës,dhe kjo mund të konfirmohet lehtë nëse shikohet me kujdesë formulari i raportimit të shkeljes disiplinore i nënshkruar nga inicuesi i kësaj procedure i datës 03/05/2019,në të cilin dokumente konstatohet fakti se nuk është argumentuar përmes provave konkrete që ankuesi ka bërë shkelje të rëndë për të i shqiptuar masën më të rëndë disiplinore, ndërsa në kërkesë për inicim të procedurës vetëm thuhet; Shërbyesi civil ka bërë shkelje të bazuar në rregulloren nr.04/2011 për procedurat disiplinore në shërbimin civil"pa saktësuar saktë dispozita konkrete ligjore që argumentojnë kërkesën dhe pa potencuar ndonjë fakt të vetëm në kërkesë që e bënë të qëndrueshëm pretendimin për shkelje të supozuar dhe që argumenton shqiptimin e masës më të rëndë.

Andaj mbi bazën e mësipërme kolegji vlerëson se Kryetari i Komunës së Prishtinës në kërkesën për inicimin e procedurës disiplinore, nuk ka identifikuar dhe konstatuar se për cilat shkelje të parimeve dhe rregullave të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovë është përgjegjës nëpunësi civil, gjegjësisht cilat janë veprimet apo mosveprimet e ankuesit gjate kryerjes se detyrës zyrtare të cilat janë cilësuar si shkelje e rëndë-serioze, dhe me cilat dispozita janë përcaktuar ato shkelje.

Ndërsa në lidhje me pretendimin sa i përket çështjes së inicimit të procedurës disiplinore ndaj ankuesit sipas raportit të shkeljes Kolegji konstaton se është i bazuar sepse inicimi i procedurës disiplinore është bërë më datë 03/06/2019 sipas njoftimit të datës 22/05/2019,ndërsa scanca në lidhje me këtë rast është mbajtë më

datë 19/06/2019 Andaj mbi këtë bazë Kolegji konstaton se iniciimi i procedurës disiplinore është bërë jashtë afatit të përcaktuar me nenin 12 paragrafi 1 dhe 3 të Rregullores Nr. 04/2011, për Procedura Disiplinor në Shërbimin Civil ku përcaktohet se: *Nëse udhëheqësi i drejtpërdrejtë konstaton se shkelja mund të cilësohet si shkelje e rëndë-serioze, në afat prej dy (2) ditë pune do ta paraqes rastin me shkrim te udhëheqësi i njësisë se personelit.*

Poashtu nga kërkesa për iniciim të procedurës disiplinore vërtetohet fakti se ankuesi ka pozitën zyrtarë për ndërtimtari dhe se nga raporti ditore që është bërë nga ky zyrtarë shihet se në vazhdimësi është raportuar në lidhje me këtë objektë udhëheqësit të tij të drejtpërdrejtë dhe u.d.shefit të sektorit,nga se sipas përshkrimit të vendit të punës të ofruar nga vetë organi i punësimit më datë 16/10/2019 vërtetohet fakti se ankuesi në cilësi të zyrtarit të ndërtimtarisë te përshkrimi i detyrave kryesore në pikën 1 parashehë; "Harton dhe zhvillon planet e punës në pajtim me mbikqyrësin për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave të njësisë dhe jep rekomandime lidhur me realizimin e këtyre objektivave" andaj mbi këtë bazë kolegji duke u bazuar në shkresat e lëndës ka konstatuar se fakti se përmes raporteve ditore/javore te udhëheqësi i drejtpërdrejtë nga ankuesi dhe ku vërtetohet se është raportuar edhe në lidhje me këtë ndërtim është argumenti bazë mbi të cilin mund të konfirmohet se ushtrimi i detyrave të zyrtarit të ndërtimtarisë në këtë rastë ankuesit ka qenë në përputhje me përshkrimin e detyrave të punës dhe se ankuesi nuk ka pozitë të inspektorit të ndërtimit por të një zyrtari që i raportonë inspektorit të ndërtimit dhe kjo rrethanë është vërtetuar nga dokumenti që është ofruar nga vetë organi i punësimit përmes provës me nr.29 në të cilin dokumentë përshkruhen specifikishtë detyrat e zyrtarit përkatës si më poshtë;

- 1.Njofton inspektorin e ndërtimit për gjendjen në teren lidhur me zhvillimin e punimeve;
- 2.Njofton inspektorin e ndërtimit për objektin në ndërtim me apo pa leje ndërtimore;
- 3.Shpreh mendimin për gjendjen e ndërtimit të objektit dhe shkallën e ndërtimit me fakte dhe të dhëna konkrete si foto,etj.
- 4.Harton proceverbale dhe për këtë menjëher lajmëron inspektorin e ndërtimit të zonës së caktuar;
- 5.Kryen punë të tjera të përcaktuara me dispozitat ligjore të ndërtimit.

Poashtu nga shkresat e lëndës ,sipas raportimeve të bëra në vazhdimësi nga ankuesi dhe mbi bazë të procesverbaleve të cilat janë të specifikuar më lartë te provat që janë dorëzuar nga ankuesi konstatohet se në vazhdimësi ankuesi bashkërisht me inspektorin e ndërtimit i kanë raportuar u.d.shefit të sektorit, më që rast vërtetohet se veprimet e ankuesit kanë qenë konformë përshkrimit të detyrave të punës, sipas dokumentit të ofruar nga vetë organi i punësimit në shkresat e lëndës,nga faqja 27 deri 29,dhe mbi këtë rrethanë vërtetohet fakti se ankuesi ka kryer obligimet konformë legjislacionit në fuqi të shërbimit civil,me faktin e raportimeve te zyrtarët kompetentë.

Ndërsa nëse shikohen me kujdes shkresat e lëndës shihet se në procesverbalin e datës 31.05.2019, Inspekcioni i ndërtimit i Komunës së Prishtinës ka nxjerrë vendim për rrënim të atij objekti, edhe për kundër faktit se ka pasur aktvendim për rrënim të objektit investitori ka vazhduar punën deri në finalizim të ndërtimit të objektit andaj mbi këtë bazë të potencuar më lartë kolegji konstaton se me faktin se drejtoria përkatëse veq ka nxjerrë vendim për rrënim ka qenë përgjegjësi e drejtorisë që të implementoj vendimin për rrënim sipas dokumentit të potencuar më lartë ,prandaj kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se me datën 27.05.2019, me numër protokolli 09, Nr. 354/02-0092621/18,Drejtoria e Inspekcionit e Komunës së Prishtinës, ka nxjerr aktvendim me të cilin ka urdhëruar të bëjë rrënimin e objektit i ekzistuese P+2, të ndërtuar në Prishtinë lagja mati 1 ,, rruga

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se Komisioni Disiplinor i Komunës së Prishtinës ankuesit i ka shqiptuar masën Disiplinorë "Ndërprerjeje e marrëdhënies së punës",me arsyetimin se me datën 15.05.2019,ankuesi ka bërë fotografimin për objektin në ndërtimin e sipër në rrugën ,, B", që dyshohej që është pa leje, një dite pasi inspektori i zonës ka kërkuar lëndën për objektin në fjalë si dhe kronologjinë e masave që janë ndërmarr për atë rast, me të cilin Komisioni disiplinore e konstaton se sipas kronologjisë të dërguara nga inspektori me datën 22.05.2019 masat e fundit që janë ndërmarr lidhur me objektin në fjalë janë para 4 muajve,prandaj kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se nga shkresat e lëndës del se Drejtorati Inspekcionit të Ndërtimit i Komunës së Prishtinës ka përgatitur rregullisht Procesverbale dhe Aktvendime për objektin në lagjen Mati 1 rruga" Venet Bajrami "procesverbali i fundit ishte i datës 31.05.2019 dhe sipas Aktvendimit të datës 27.05.2019 të Drejtorisë së Inspekcionit të Komunës së Prishtinës, i cili aktvendim ka urdhëruar pronarin Shaban Kongjilli, që të beje rrënimin e Objektit të ndërtuar në Prishtinë, lagja mati 1,rruga,

dhe se në shkresat e lëndës/procesverbaleve të datës 17.04.2018, 24.04.2018, 08.05.2018, 26.06.2018, 13.11.2018 del se vazhdimisht është bërë konstatim i gjendjes faktike lidhur me objektin dhe se nga Inspektoret e Drejtorisë së Inspekcionit, me të cilët ka qene edhe ankuesi vazhdimisht është rekomanduar që të ndërpriten punimet nga Investitori i lartcekur, duke plotësuar këto procesverbale edhe me fotografi konkrete si ato të datës 26.06.2018, 07.05.2018, 23.04.2018, 24.04.2018, 16.04.2018, 18.04.2018, tregojnë qartë sa i përket gjendjes lidhur me ndërtimin e objektit,poashtu nga shkresat e lëndës, nëse i referohemi raportit të datës 27/02/2019 vërtetohet edhe më shumë fakti që ankuesi sipas kësaj lënde kishte propozuar masa ndaj këtij ndërtimi paleje dhe poashtu kishte njoftuar hollësisht në lidhje me ndërtimet në at zonë të përgjegjësisë u.d.shefin e sektorit të ndërtimit.

Mbi këtë bazë konstatohet fakti se veprimet janë adresuar te organet kompetente qysh më herët nga viti 2018,dhe që kjo rrethanë e bënë të qëndrueshëm pretendimin e ankuesit se në vazhdimësi ka raportuar në lidhje me këtë objekt te inspektori i zonës dhe shefi i sektorit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se Komisioni Disiplinor i Komunës së Prishtinës, sipas vendimit me numër 14-116/01-184530/19 të datës 29.07.2019, me të cilin ankuesit i ka aprovuar ankesën ndërsa Vendimi i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i datës 17.07.2021, në pikën e dytë të dispozitivit i ka shqiptuar masën disiplinore, **Ndërprerje e marrëdhënies së punës**, veprim ky i cili është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi dhe atë në nenin 13, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, 1.2 të Rregullores 04/2011, për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, ku përcaktohet se; **1. Komisioni Disiplinor ka këto kompetenca: 1.1 të dëgjojë provat lidhur me shkeljen e supozuar 1.2 , të vendose , në bazë të provave, nëse është kryer shkelja,** prandaj kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se Komisioni Disiplinor në pikën e parë të dispozitivit, e ka aprovuar Vendimin e datës 17.07.2019, të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, veprim ky i cili është në kundërshtim me kompetencat e Komisionit Disiplinor, sepse kompetencë e komisionit disiplinore është që të vendos në bazë të provave dhe fakteve relevante, në lidhje me kërkesën për inicimin të procedurës disiplinore, të parashtruar nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i institucionit ashtu siç e përcaktojnë dispozitat ligjore në fuqi, andaj mbi këtë bazë pretendimi ankimor është i bazuar.

Kolegji konstaton se edhe Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave në komunë të Prishtinës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me nr. 14-070/01-0196434/19 të datës 10.09.2019, përmes të cilit ka refuzuar ankesën e ankuesit dhe ka lënë në fuqi Vendimin me numër 14-116/01-184530/19, datë 26.07.2019 i protokolluar më datë 29/07/2019 të Komisionit Disiplinore, nuk ka vërtetuar në mënyrë të drejtët dhe të plotë gjendjen faktike dhe gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale, duke vepruar kështu në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Ligjit Nr.02/L-28 për Procedurën Administrative. Ndërsa nga komuna e Prishtinës poashtu me rastin e marrjes së përgjigjes në ankesë, në përgjigjen e tyre të datës 15/10/2019 nuk kemi marrë ndonjë përgjigje që argumenton pretendimin e tyre në lidhje me shqyrtimin e masës disiplinore përveç që na kanë kthyer përgjigje duke na bashkangjitur disa prova, poashtu përgjigjja është dërguar jashtë afatit ligjor të paraparë me ligjin Nr.06/L-048 për KPMSHICK-në, pasi shkresa nga komuna e Prishtinës për përgjigje në ankesë është pranuar më datë 25/09/2019, që konfirmohet me flet kthesë të datës 25/09/2019, ndërsa në nenin 17 paragrafi 3 të këtij neni shprehimisht parashihet: **"Organi i punësimit është i obliguar që brenda afatit prej pesë (5) ditësh pune, nga dita e pranimit të kërkesës për përgjigje në ankesë, të kthejë përgjigje dhe të ofrojë të gjitha dëshmitë që i kërkon Këshilli"**. Andaj kolegji edhe mbi këtë bazë konstaton se pretendimi sa i përket ankesës është i bazuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosje vlerëson se Vendimit të Komisionit Disiplinor i mungon arsyetimi ashtu siç është përcaktuar në nenin 48 të Ligji Nr. 05/L. -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ngase vendimi përkatësisht arsyetimi i vendimit duhet që të ketë shpjegimin e situatës faktike mbi të cilin është marrë vendimi, shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave, bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret. Në

arsyetimin e vendimit Komisioni Disiplinor i Komunës së Prishtinës dhe Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave nuk kanë dhënë arsye mbi faktet vendimtare që e kanë kushtëzuar shqiptimin e masës disiplinore gjegjësisht ndërprerjen e marrëdhënies së punës ankuesit. Andaj, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave konstaton se Komisioni Disiplinor duke mos saktësuar shkeljet dhe përgjegjësitë e ankuesit me veprimet dhe mosveprimet e tija ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 51, 52,55, 64 dhe 65 të Ligjit Nr. 03/I-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe nenin 6 të Rregullores Nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, me çka Kolegji konstaton se edhe masa e shqiptuar është në kundërshtim me nenin 67 paragrafin 1 nënparagrafin 1.2 nën-nëparagrafin 1.2.4 të Ligjit Nr. 03/I-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Andaj mbi bazë të provave të administruara, të dorëzuara nga palët në procedurë konstaton se egziston baza ligjore për aprovimin e ankesës së ankuesit ashtu që komuna e Prishtinës është e obliguar që të zbatojë vendimin e Këshillit duke e kthyer në vend të punës ankuesin sipas akt emërimit nr.01-112-859 të datës 01/08/2016, si: „Zyrtar për Ndërtim“, dhe poashtu të kompensoj të ardhurat personale sipas akt emërimit nga momenti i largimit deri në momentin e kthimit në vend të punës sipas këtij vendimi.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga kryetari i kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.nr.196/2021,datë 26/04/2021

Ilire Mehmeti Shaqiri

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Prishtinës :
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së



m

Handwritten text, possibly a signature or name, located in the upper left quadrant.